



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30 seminare
Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I, Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Përvetësim e zbatim i teknikave përkthimore të teksteve me karakter teknik, nga gjuha amtare në gjuhën e parë të punës. Përvetësim i mjeteve për të kuptuar / riformuluar / rishikuar tekstin dhe analizë e tij duke përdorur metodat dhe strategjitë e përkthimit përkatëse. Përcjellje e kuptimit duke respektuar mesazhin e synuar, objektivat dhe qëllimet e tekstit, pritshmërinë e audiencës së synuar, si edhe shtrëngesat terminologjike; Analizë e procesit të përkthimit dhe formësim i një gjykimi personal, të arsyeshëm dhe aktiv.

Objektivat specifike lëndore:

- Aftësim i studentit për të përkthyer në mënyrë autonome dhe të arsyetuar tekste teknike.
- Të njohë, praktikojë dhe mobilizojë njohuritë rreth metodave dhe strategjive të procesit të përkthimit të teksteve teknike.
- Përfitim i aftësive redaktuese të nevojshme për përkthyesin në mënyrë që të jetë efektiv në treg.
- Përforsim i kompetencës redaktuese në gjuhën amtare.

Rezultate të pritshme:

- Në fund të kursit synohet që studentët të kenë përfutur aftësi dhe kompetenca të thelluara, përkthimore, përkatësisht:
- Aftësim për të përkthyer tekste të ndryshme specialiteti (drejtësi, ekonomi, mjekësi) për të rishikuar dhe rilexuar përkthimin e tij.
- Zotërim i teknikave të përkthimit të teksteve të specialitetit nga gjuha shqipe në frëngjishte.
- Përfitim i njohurive tematike të dobishme për të kuptuar, analizuar dhe kontekstualizuar aktivitetin e përkthimit.
- Aftësim për të përkthyer tekste teknike duke përdorur kërkimin dokumentar dhe atë terminologjik.